

**AKT I THEMELIMIT  
DHE  
STAUTUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**“Natyral exclusive distribution“ (Ned) shpk**

Ne Tirane, sot me date 08.02.2021, me cilesine e “ortakut te vetem themelues”, Shoqeria “NATYRAL INVEST” shpk, nje shoperi shqiptare, pajisur me NUIS (NIPT): L81330006V, perfaqesuar nga administratori i saj, Z. Klodian Shatraj, madhor, me zotesi jurdike dhe per te vepruar, identifikuar e dokumentin e identifikimit, nr. I10226140S, me vullnet te lire, te plete e te sinqerte, harton aktet (Akt themelimi & Statut), per themelimin e *shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, me emertimin ‘Natyral exclusive distribution“ (Ned) shpk.*

**KREU I**

**Neni 1  
Krijimi**

Shoqeria “**Natyral exclusive distribution“ (Ned) shpk**, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoperi me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

**Neni 2  
Personaliteti juridik**

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jete regjistruar ne QKB, ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria “**Natyral exclusive distribution“ shpk, me shkurtimet e saj (Ned) shpk**, eshte nje shoperi tregtare, e themeluar nga “ortaku i vetem”, i cili nuk perggjigjet per detyrimet e shoqerise tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkruara. Kontributi i ortakut perben kapitalin e regjistruar te shoqerise.

Ortaku gezon kuoten e tij ne shoqeri, ne perpjeshet me kontributin qe ka dhene ne kapital.

**Neni 3  
Selia**

Shoqeria e ka seline kryesore ne adresen : **Tirane, Njesia Bashkiake NR.5, Rruga «Medar Shtylla», Ndertesa nr.43, Hyrja 11, Apartamenti nr.4, kodi postar 1019.**

Shoqeria mund te ndryshoje seline e tij, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te Ortakut te Vetem.

**Neni 4  
Objekti i veprimtarise**

**Shoqeria ka per objekt: Sherbim marketingu dhe distribucioni. Tregeti me shumice e pakice te produktave ushqimore dhe blegtoriale, Agrobiznes, Import-eksport dhe tregeti e gjese se gjalle dhe artikujve bujqesor e blegtoral. Tregtim te ushqimit per blegtorine si dhe cdo aktivitet tjeter tregtar dhe**



*financiar qe i sherben realizimit te objektivit te saj. Import-eksport dhe tregetim te mallrave te aksizes. Import-eksport te produkteve ushqimore me origjine shtazore, Bar, Restoran dhe Katering, etj. Pjesmarrje ne shoperi me objekte aktiviteti ne fushen e ndertimit, agroturizem, investime ne energjetike, imobiliare, tregti me shumice e pakice, transport, prodhim dhe perpunim, import-export etj. Ne perputhje me legjislacionin shqiptar, Shoqeria mund te krye dhe te realizoje cdo aktivitet qe lidhet direkt ose indirekt, apo ka te beje me objektivat e renditura me siper. Per te arritur qellimin e mesiperm Shoqeria mund te ndermarre veprime me pasuri te luajtshme apo te paluajtshme dhe cdo aktivitet tregtar apo financiar, per dhenie me qira apo hipotekim qe mund te konsiderohen te dobishme apo te nevojshme ne menyre qe te arrihet objektivi i Shoqerise. Perveç veprimtarive te parashikuara me lart, ne vepimtarine e shoqerise do te hyje cdo veprimitari qe do te konsiderohet nga ortaket si e nevojshme dhe e pershatshme per arritjen e objektit te shoqerise dhe qe nuk vjen ne kundershtim me Ligjin Shqiptar.*

**Neni 5  
Kohezgjatja**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per një periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKB.

**KREU II  
KAPITALI**

**Neni 6  
Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 000 leke (te reja), i ndare ne një kuote.

- Shoqeria "NATYRAL INVEST", Pajisur me NIPT: L81330006V, eshte zoterues i 1(nje) kuote me vlerë 100 000, e cila perfaqeson 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Kontributi i ortakut mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme apo te drejta) Ortaku per gjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

**Neni 7  
Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit**

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre.

Kapitali i regjistruar i shoqerise mund te zvogelohet me vendim te Ortakut te Vetem ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

**Neni 8  
Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me perjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) shitblerjes;
- c) trashegimise;
- ç) dhurimit;

d) çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim.

### KREU III ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

#### *Neni 9*

#### *Organi Vendimmarres*

Ortaku i Vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Ortaku i Vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Ortaku i vetem, vendos per çeshtje si :

- a) percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- c) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- ç) percaktimin e shperblimeve
- d) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire perqatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- f) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;

Te gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetem regjistrohen ne nje register te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen. Duhen regjistruar ne veçanti, por pa u kufizuar ne to, vendimet per:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- b) shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme. Shoqeria nuk mund t'i kundrejtoje pavlefshmerine te tretit, qe ka fituar te drejta ne mirebesim, perveç rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine, apo ne baze te rr Ethanave te qarta nuk mund te mos kishte pasur dijeni per te.

#### *Neni 10*

#### *Administrimi*

Administrator i shoqerise eshte **Z. Klodian Llade Shatraj**.

Administratori i shoqerise do te ushtroje kompetencat e administrimit per nje afat 5 vjecar me te drejte riperteritje.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Ortakut te Vetem te shoqerise. Administrator i shoqerise mund te emerohet edhe nje person i trete jashte ortakerise.

#### *Neni 11*

#### *Kompetencat*

Administratori ka te drejte e detyrohet te:

- a) kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem dhe te jashtezakonshem te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga ortaku i vetem;
- b) perfaqesoje shoqerine tregtare;



- c) kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- d) pergatisi dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe reportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara ortakut te vetem per miratim;
- e) krijoje nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rr Ethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- f) kryeje regjistrimet dhe dergoj te dhenat e detyrueshme te shoqerise, siç parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;
- g) raportoje perpara asamblese se per gjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e shoqerise tregtare;

Administratori eshte i detyruar te therrasi mbledhjen e ortakut te vetem edhe ne rastet kur :

- a) sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim dhe kur shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te tij, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlore me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara;
- b) Administratori ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet e administrimite zakonshem e te jashtezakonshem. Administratori perfaqeson Shoqerine perpara te gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo te huaj, autoriteteteve shteterore Shqiptare apo te huaja, Bankave te te gjitha niveleve, zyrate te tatim taksave, autoriteteteve doganore, perfshi ketu edhe autoritetet gjyqesore te gjitha shkalleve. Administratori angazhon shoqerine ne marredheniet me te tretet nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e tij.

Shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i administratorit e kalonte objektin e shoqerise ose kur te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rr Ethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.

### *Neni 12 Pergjegjesite*

1. Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimite shoqerise.

Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga Ortaku i Vetem qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

Perveç sa eshte parashikuar ne dispozitat e per gjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

- a) te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te veçante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjesdis;
  - b) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;
  - c) te vleresoje me pergjegjesi çeshtjet, per te cilat merret vendim;
  - d) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ata te shoqerise;
  - e) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshem.
2. Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, per gjigjet ndaj shoqerise per çdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me perjashtim te

rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

3. Nese administratori vepron ne kundershtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 te ketij neni, eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt e sipas standardeve te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata per gjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidare.
4. Ne menyre te vecante, por pa u kufizuar ne to, administratori eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara, nese, ne kundershtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e meposhtme:
  - a) u kthen ortakeve kontributet;
  - b) u paguan ortakeve interesa apo dividende;
  - c) u shperndan aktivet shoqerise;
  - d) lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur, ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet;
  - e) jep kredi.

#### **Neni 13**

##### **Viti Financiar**

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare Biznesit dhe mbyllte me 31 Dhjetor.

#### **Neni 14**

##### **Bilanci i shoqerise dhe dividentet**

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit finanziar, Mbledhja e Ortakut te Vetem, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakut te Vetem vendos rreth shperndarjes se dividentit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem finanziar, siç edhe parashikohet nga ligji.

#### **Neni 15**

Te ardhurat neto ( Dividenti ) qe mbeten pas vecimit te fondev te ligjore te mesiperme dhe te atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj te treteve, i mbeten dhe i kalojne ne pronesi, ortakut te vetem te shoqerise.

#### **Neni 16**

##### **Prishja e shoqerise**

Shoqeria me perjegjesi te kufizuar prishet:

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
- b) me vendim te asamblese se per gjithshme;
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit;
- d) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Regjistrimin e Biznesit";
- e) me vendim te gjykates;



f) per arsyte te tjera, te parashikuara ne statut.

#### **Neni 17**

##### **Te drejtat e detyrimet e likuiduesit**

Likuiduesi merr persiper te drejtat dhe detyrimet e administratoreve nga data e emerimit te tij.

Nese shoqeria emeron me shume se nje likuidues, perveçse kur akti i emerimit parashikon se ata veprojne veçmas njeri-tjetrit, likuiduesit ushtrojne bashkerisht te drejtat e detyrimet sipas ketij ligji. Likuiduesit mund te autorizojne njerin prej tyre te kryeje veprime te nje kategorie te posaçme. Kufizimet e tagrave te likuiduesve u kundrejtohen te treteve, ne perputhje me percaktimet e ligjit. Likuiduesi u nenshtrohet mbikeqyrjes se ortakut dhe administratorit.

#### **Neni 18**

##### **Perfundimi i likuidimit**

Pas shperndarjes se aktiveve te mbetur, likuiduesi e njofton Qendren Kombetare te Biznesit per perfundimin e likuidimit dhe kerkon çregjistrimin e shoqerise, ne perputhje me seksionin V te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Regjistrimin e Biznesit".

#### **Neni 19**

##### **Bashkimi**

Dy ose me shume shoqeri mund te bashkohen nepermjet:

1. Kalimit te te gjitha aktiveve e pasiveve te njeres ose me shume prej shoqerive, qe quhen shoquerite e perthithura, te nje shoqeri tjeter ekzistuese, e quajtur shoqeria perthithese, ne kembim te aksioneve apo kuotave te ketij shoqerie. Ky proces quhet bashkim me perthithje.
2. Themelimit te nje shoqerie te re, tek e cila kalohen te gjitha aktivet e pasivet e shoqerive ekzistuese, qe bashkohen ne kembim te aksioneve apo kuotave te shoqerise se re. Ky proces quhet bashkim me krijim i nje shoqerie te re.

#### **Neni 20**

##### **Ndarja**

1. Nje shoqeri mund te ndahet me vendim te Asamblese se Ortakeve, duke transferuar te gjitha aktivet e pasivet e veta ne favor te dy ose me shume shoqerive ekzistuese apo te themeluara rishtazi. Shoqeria qe ndahet, vleresohet e prishur.
2. Per ndarjen e shoqerise zbatohen perkatesisht dispozitat e neneve te ligjit 9901 date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar.

#### **Neni 21**

##### **Shnderrimi**

Shoqeria mund ta ndryshoje formen e vet ligjore, nepermjet shnderrimit te tij ne shoqeri aksionare.

#### **Neni 22**

##### **Baza Ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptare.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

*Neni 23*  
*Mosmarreveshjet*

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jetë kompetente Gjykatat Shqiptare.

*Neni 25*  
*Dispozita perfundimtare*

Ky Statut i shoqerise "**Natyral exclusive distribution**" (Ned) shpk, u redaktua nga une "ortaku themelues" ne 4 ekzemplare me vlera te njejtë juridike ne gjuhen shqipe, me permajtje dhe vlera te njejtë juridike.

**Ortaku i Vetem i Shoqerise Natyral exclusive Distribution " (Ned) shpk**

Shoqeria "NATYRAL INVEST" shpk  
perfaqesuar nga administratori i saj

Z. Klodian Shatraj

